



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.35, datë 14.10. 2019

MBI

**“SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SIPËRMARRËSIT
“NEOFONE” SH.P.K.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
3. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
4. Znj.Xhoana	Lilaj	Anëtar

dhe sekretare Znj.Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 14.10.2019, në mbështetje të Ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për Funksonimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Rregullores së Brendshme “Për Funksonimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“SHQYRTIMI I ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SIPËRMARRËSIT “NEOFONE”,
SH.P.K.**

BAZA LIGJORE:

1. Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**); Neni 130 e vijues;
3. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Ankimi administrativ i sipërmarrësit Neofone sh.p.k shkresë nr. prot 287 datë 02.12.2015 (AKEP nr. prot 2148 datë 03.12.2015) për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Neofone sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a (*Ankimi administrativ*),
2. Shkresë AKEP nr. prot 2148/1 datë 17.12.2015 me lëndë: “Mbi kërkesën Tuaj nr. prot 287 datë 02.12.2015, përgjigje sipërmarrësit Neofone sh.p.k, në lidhje me ankimin e depozituar.
3. Vendimi gjyqësor Nr. 1538 datë 31.03.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë,
4. Vendimi gjyqësor nr. 2112 datë 04.07.2019 të Gjykatës së Apelit Administrativ,
5. Relacionin shpjegues mbi trajtimin e çështjes (*Relacioni*);
6. Projekt-Aktin vendimarrës të Këshillit Drejtues në përfundim të shqyrtimit të praktikës së rekomanduar nga struktura e ngarkuar për trajtimin e çështjes,

V Ë R E N:

I. Në aspektin procedural:

Nga shqyrtimi i pretendimeve të sipërmarrësit ankimues Neofone sh.p.k, arsyetimeve dhe akteve të paraqitura në dosjen administrative dhe gjyqësore si dhe nga analiza e plotë e çështjes objekt shqyrtimi, organi administrativ përpara të cilit drejtohet dhe shqyrtohet çështja sipas shkronjës a) të nenit 134/1 të ligjit nr. 44/2015, është Këshilli Drejtues i AKEP;

1. Sipërmarrësi Neofone sh.p.k. me anë të shkresës nr. prot 287 datë 02.12.2015 (adminstruar ne AKEP nr. prot 2148 datë 03.12.2015) i është drejtuar AKEP, me Ankim Administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Neofone sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a. Nëpërmjet shkresës së cituar Neofone ka paraqitur një kronologji të marrëveshjeve të interkoneksionit nënshkruar me sipërmarrësin Vodafone Albania dhe vendimeve të AKEP për rregullimin dhe de-rregullimin e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare duke ankimuar tarifën e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të njoftuar nga Vodafone Albania për t’u aplikuar nga data 9.10.2015.

Bazuar në Nenin 21, Nenin 46 dhe Nenin 149 të KPrA si dhe Neni 60 dhe 120 i Ligjit 9918, i ndryshuar, Neofone kërkon pranimin për shqyrtimin e Ankimit Administrativ nga ana e AKEP, si organi kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis sipërmarrësve të komunikimeve elektronike në R.SH dhe konkretisht midis Vodafone Albania dhe Neofone sh.p.k.

Bazuar në Nenin 100 të K.Pr.A, Neofone kërkon nga AKEP trajtimin e të gjitha kërkesave të Neofone në mënyrë specifike e të detajuar, pa shmangie dhe hapësira për keqinterpretime midis palëve. Sipas tij, AKEP duhet të përcaktojë qartësisht kuptimin e

Vendimit Nr.1740 datë 20.12.2011, pika 1 e dispozitivit, i cili ka lënë vend për keqkuptime midis palëve e sidomos të shkronjës b) ii të pikës 2 të dispozitivit të VKD nr. 1347, datë 23.07.2010 të rivendosur në fuqi nga AKEP e shprehur si vijon : *“ii.Objekt negociatash komerciale për thirrjet hyrëse ndërkombëtare”*.

Bazuar në Kodin e Procedurës Adinistrative, Nenin 7, 8, 48, 49,50, 51, 53, 57, 60, 120 të Ligjit 9918, i ndryshuar, VKD Nr.1506,datë 10.02.2011 , VKD Nr.2525, datë 6.11.2014, Nr.2542, datë 13.03. 2015, Neofone kërkon nga AKEP:

- Përcaktimin e tarifës maksimale dhe kapaciteteve minimale të interkoneksionit për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin e Vodafone Albania sh.a e të tranzituar nga Neofone sh.p.k për të gjithë periudhën nga momenti i ndërprerjes të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare datë 10.04.2015 nga Vodafone Albania sh. a e në vazhdim bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Civil, aktet ligjore dhe nënligjore që operojnë në Republikën e Shqipërisë si dhe Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në RSH”, i ndryshuar.
 - Detyrimin e Vodafone Albania Sh.a për hapjen e kanaleve të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare të tranzituara nga Neofone Sh.p.k bazuar në nenin 60 të Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në RSH", i ndryshuar. Alokimin e faciliteteve shoqëruese në shërbim të Neofone për terminimin e trafikut ndërkombëtar nga Vodafone Albania.
 - Përcaktimin e kapacitetit minimal të interkoneksionit 1 x El (2,048 Mbps ose 32 kanale) për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare drejt rrjetit të Vodafone Albania sh.a të tranzituara nga Neofone sh.p.k, sipas referencës tek Ligji Nr.9918 datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në RSH", i ndryshuar, e më specifikisht rekomandimeve G700 - G795 të ITU-së.
 - Nxjerrjen në një kohë sa më të shkurter të vendimit të AKEP, për të mënjanuar sadopak dëmtimin e pamasë (laesio enormis) kundrejt operatorit Neofone sh.p.k.
2. AKEP me shkresën nr. prot 2148/1 datë 17.12.2015 me lëndë: “Mbi kërkesën Tuaj nr. prot 287 datë 02.12.2015, i është përgjigjur zyrtarisht sipërmarrësit Neofone sh.p.k në lidhje me ankimin e depozituar. Përgjigja e AKEP ka konsistuar:

Të dy objektet e çështjeve të paraqitura nga Neofone sh.p.k si mosmarrëveshje me sipërmarrësin Vodafone Albania sh.a të cilat kanë të bëjnë me :

1. *Përcaktimin e tarifës maksimale për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin e Vodafone Albania sh.a*
2. *Përcaktimin e kapaciteteve minimale të interkoneksionit për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin Vodafone Albania sh.a*

Lidhen me shërbimin e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, shërbim i cili është i derregulluar plotësisht nga AKEP (shih VKD nr. 2523 datë 06.11.2014 i ndryshuar), kështu që çdo marrëveshje e mundshme midis palëve është plotësisht e ndërtuar mbi baza komerciale.

Bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator kërkesa e sipërmarrësit Neofone sh.p.k për pranimin për shqyrtim të Ankimit Administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis Vodafone Albania sh.a dhe Neofone sh.p.k nuk është pranuar.

3. Në vijim të përgjigjes së AKEP me shkresën nr.prot 2148/1 datë 17.12.2015, Sipërmarrësi Neofone sh.p.k i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesë-padi, me objekt:

“Detyrimin e të paditurit Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), të nxjerrë aktin administrativ në përputhje me Ligjin nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me Ligjin nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.9918) dhe marrjen e masave për rivendosjen e të drejtës së cënuar”.

Sipërmarrësi Neofone sh.p.k, në padi pretendon se:

- në kushtet e mosarritjes së një Marrëveshje me sipërmarrësin Vodafone Albania sh.a, AKEP bazuar në nenet 50, 60 dhe 120 të Ligjit 9918/2008 i ndryshuar kishte detyrimin të dilte me Urdhër.
Sipas tij, shkresa me nr. prot 2148/1 prot. datë 17.12.2015 nxjerrë nga Kryetari i AKEP nuk është në vetvete një akt administrativ në kuptim të nenit 105 të K.Pr.A që sjell efekte juridike për paditësin e në këtë kontekst kërkesa e të paditurit për të nxjerrë aktin në përputhje me Ligjin është një kërkesë e drejtë dhe e bazuar në ligj sepse qëllimi i kërkesës së paditësit drejtuar AKEP nuk ka qenë informimi për VKD por zgjidhja e një të drejte që Neofone sh.p.k pretendon se ka në lidhje me mosmarrëveshjen objekt të ankimit administrativ dhe që ligji parashikon detyrimin e AKEP për të dalë me Urdhër.
- ka qenë detyrim i AKEP që të shqyrtonte kërkesën e sipërmarrësit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Vodafone Albania sh.a dhe Neofone sh.p.k për përcaktimin e tarifës maksimale dhe kapaciteteve minimale të interkoneksionit për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin e Vodafone Albania sh.a e të tranzituara nga Neofone sh.p.k për të gjithë periudhën nga momenti i ndërprerjes së terminimit të thirrjeve ndërkombëtare datë 9.10.2015 nga Vodafone Albania sh.a e në vazhdim si dhe detyrimin e Vodafone Albania sh.a për hapjen e kanaleve të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare të tranzituara nga Neofone sh.p.k.
- Gjithashtu AKEP duhet të shqyrtonte kërkesën e Neofone sh.p.k edhe për hapjen e aksesit dhe interkoneksionit dhe alokimin e faciliteteve shoqëruese në shërbim të Neofone sh.p.k për terminimin e trafikut ndërkombëtar nga Vodafone Albania sh.a, dhe pasi ta shqyrtonte atë t'i përgjigjej me Vendim të arsyetuar për pranimin ose refuzimin e saj, ankimi nuk ka vajtur në Këshillit Drejtues të AKEP, është kthyer një përgjigje në kundërshtim me Ligjin.

4. Me Vendimin Nr. 1538 datë 31.03.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, vendosi:
 - Pranimin e kërkesë padisë së paditësit Neofone sh.p.k.
 - Detyrimin e pales se paditur te nxjerre aktin administrativ ne lidhje me ankimin nr 287 prot, date 02.12.2015 te shoqerise Neofone
 - Shpenzimet gjyqësore ne ngarkim palës së paditur
 - Ky vendim eshte i ekzekutueshem nga Zyra e Përmabrimit
 - Ngarkohet Zyra e përmabrimit
 - Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ brenda 15 ditëve duke filluar që nga e nesërmja e shpalljes së këtij Vendimi.

5. Me Vendimin nr. 2112 datë 04.07.2019 Gjykata e Apelit Administrativ, në dhomë këshillimi vendosi:
 - Lënien në fuqi të Vendimit nr.1538, datë 31.03.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
 - Detyrimin e të paditurit AKEP të disponojë aktin administrativ në lidhje me ankimin nr. 287 datë 02.12.2015 në përputhje me Ligjin nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
 - Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur;
 - E drejta e Rekursit kundër këtij Vendimi mund të ushtrohet në Gjykatën e Lartë brenda 30 ditëve duke filluar nga e nesërmja e komunikimit të tij palëve ndërgjyqëse.

6. Më shkresë nr. prot 2080 prot AKEP, datë 23.09.2019 AKEP është njohur me shkresën e zyrës permbarimore Albius me lëndë “ Lajmërim për ekzekutim vullnetar”.

7. AKEP, me shkresën nr.2080/1 prot., datë 03.10.2019, i është përgjigjur zyrtarisht Shoqërisë Përmbaremore “Albius” sh.p.k.

II. Në aspektin e trajtimit në thelb të çështjes:

8. Këshilli Drejtues i AKEP, shqyrton këtë ankim administrativ bazuar ne Vendimin Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë nr.1538,datë 31.03.2016, vendim ky i cili ka marrë formë të prerë me Vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit nr.2112, datë 04.07.2019 dhe rrjedhimisht shqyrtimi administrativ përfshin periudhen kohore deri në momentin e paraqitjes së kërkesës përkatëse nga subjekti Neofone sh.p.k, me datë 02.12.2015.

9. Neofone rezulton se ka informacion të mjaftueshëm në lidhje me vendimet e AKEP për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare dhe interpretimet/sqarimet e AKEP për të kuptuar de-rregullimin e kryer, pasi ka marrë pjesë me komente në këshillimet publike të Analizave të tregut celular (Neofone është fokusuar në komente në lidhje me trajtimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare), si dhe ka ankimuar administrativisht vendimet e AKEP për implementimin e de-rregullimit të tarifës së terminimit të këtyre thirrjeve në RIO (Ofertat Referencë të Interkoneksionit) dhe ka qenë pjesë e disa procedurave për zgjidhje mosmarrveshje për përcaktimin e këtyre tarifave komerciale në vitin 2012, dhe për të gjitha këto

procese AKEP ka dhënë sqarimet e duhura, të publikuara edhe në faqen ëeb të AKEP, përfshirë dhe njoftimet individuale për proceset ku ka qenë palë në mos-marrveshje apo ankim administrativ.

9. Sic është sqaruar në shkresën e AKEP me nr. 2148/1 Prot., datë 17.12.2015, dërguar Neofone, të dy objektet e çështjeve të paraqitura nga Neofone sh.p.k si mosmarrëveshje me sipërmarrësin Vodafone Albania sh.a lidhen me shërbimin e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, shërbim i cili në kohën e lindjes së mosmarrëveshjes deri aktualisht është i de-rregulluar plotësisht nga AKEP nëpërmjet Vendimit nr.2523, datë 6.11.2014, i ndryshuar, kështu që çdo marrveshje e mundshme e lidhur ndërmjet palëve është plotësisht e ndërtuar mbi baza komerciale. Në Vendimin nr.2523, datë 6.11.2014, në pikën 1 të dispozitivit Vodafone përcaktohet me FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Vodafone Albania, por nëpërmjet shënimit (footnote) 1 në këtë vendim, sqarohet se *përkufizimi i tregut përkatës është dhënë në dokumentin përfundimtar të analizës së tregut dhe statusi me FNT është për terminimin e thirrjeve të origjinuara nga pajtimtarët e rrjeteve celulare dhe fikse kombëtare.*
10. Në dokumentin e analizës së tregut të vitit 2014, miratuar me VKD nr.2522, datë 6.11.2014, AKEP ka sqaruar se në vijim të perfundimeve të Analizës së tregut 2012, tregu përkatës i terminimit përfshin vetëm terminimin e thirrjeve kombëtare. Në Analizën e tregut celular, të miratuar me VKD nr. 2118, datë 4.07.2012, AKEP ka përfshirë një seksion të veçantë (Seksioni III.3.III) për diskutimin në lidhje me detyrimet për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, duke përfshirë dhe kronologjinë derregullimit të këtij shërbimi. Në këtë dokument AKEP përcaktoi që terminimi i thirrjeve ndërkombëtare në një rrjet celular nuk është pjesë e tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjet celular, pra statusi me FNT dhe gjithë detyrimet e tjera për FNT për terminimin e thirrjeve janë të zbatueshme vetëm për terminimin e thirrjeve hyrëse kombëtare. Ky përfundim është arritur pas këshillimit publik, ku dhe Neofone ka qenë pjesëmarrës në proces me komente, dhe AKEP gjykoj se alternativa e duhur për derregullimin ishte alternativa ‘c’ e pyetjes 5 të këshillimit publik:

Detyrimet e operatoreve me FNT për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare duhet të de-rregullohen plotësisht: operatorët celulare të mos kenë detyrim të japin akses, pra dhenia e aksesit dhe tarifa të jone komerciale kur kanë interes të dy palet.

11. Në bazë të këtij përfundimi, AKEP në vendimet përkatëse për shpalljen me FNT të operatorëve celularë, ka hequr detyrimet e operatorëve celularë për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare. Këto detyrime janë hequr edhe për sipërmarrësin Vodafone Albania me VKD nr. 2122 datë 4.7.2012, ku AKEP në pikat 6.3 dhe 6.4 të vendimit ka vendosur që:
 - i. *Detyrimet e Vodafone Albania sh.a. për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të përcaktuara në vendimin nr.1211, datë 31.03.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP, dhe amendimet e tij, hiqen.*
 - ii. *Heqja e detyrimeve të cituar në pikën 6.3 më sipër bëhet efektive më 1.09.2012.”*

Heqja e këtij detyrimi është reflektuar edhe në ofertat referencë të interkoneksionit (RIO) të operatorëve celularë të miratuara nga AKEP më 29.10.2012, përfshirë

edhe RIO e Vodafonit të miratuar me VKD nr.2179, datë 29.10.2012, ku në pjesën hyrëse citohet ndër të tjera se:

Kjo ORI nuk mbulon terminimin e thirrjeve hyrese nderkombetare (qofte ato te terminuarata drejtperdrejte nga operatoret nderkomberatre qofte ato te tranzitura nga operatoret e licensuar ne Rep. e Shqiperise nepermjet tranzitimit te thirrjeve nderkombetare), drejt pajtimtareve/abonentet te rrjetit VOADPHONE ALBANIA. Ky lloj sherbimi, do te trajtohet ne marreveshje te vecanta tregtare mes VODAFONE ALBANIA dhe partnereve te saj, rast pas rasti. VODAFONE ALBANIA ka detyrimin te pranoje per teminim vetem thirrje telefonike te destinuar per abonentet/pajtimtaret e VODAFONE ALBANIA te cituar me siper. Eshte pergjegjesia e Operatorit Perfitues te rrugezoje thirrjet drejt rrjetit te duhur per numrat e portuar, duke bere analizen e thirrjeve ne perputhje me rregullat e vendosura nga AKEP per portabilitetin e numrave dhe rrugezimin e thirrjeve drejt tyre.

12. Heqja e statusit me FNT dhe detyrimeve për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare hyri në fuqi më 1.09.2012 dhe përbën një derregullim të plotë të këtij shërbimi, dhe ndryshon nga de-rregullimi i pjesshëm i këtyre thirrjeve të përcaktuara në VKD Nr. 1740 date 20.12.2011 dhe VKD nr. 1347, date 23. 07. 2010, (dhe vendimet e tjera për operatorët e tjere celularë) që hynë në fuqi më 1.02.2012, pasi:

- Bazuar ne vendimet e datës 20.12.2011 si dhe ne vendimet e datës 23.07.2010, që hynë në fuqi më 1.02.2012, **operatoret celulare ishin me FNT per terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare** dhe kishin detyrim per te dhene akses per terminimin e këtyre thirrjeve per operatoret vendas qe tranzitonin keto thirrje, detyrim për mos-diskriminim midis operatorëve të ndryshëm, por nuk kishin detyrim për rregullim tarife pra shërbimi ofrohej me tarifa komerciale te cilat vendosen ne negociata midis operatorit terminues dhe atij tranzitues. Ne kendveshtrim te perkufizimit te tregut perkates ky trajtim nenkupton qe tregu perkates i terminimit te thirrjeve ne nje rrjet, perfshin thirrjet hyrese me origjine kombetare dhe nderkombetare, si dhe secili operator ka FNT per kete treg perkates, por detyrimet per FNT jane te ndryshme per dy llojet e thirrjeve: për terminimin e thirrjeve kombëtare përfshihej dhe detyrimi i rregullimit të tarifës ndërsa për thirrjet ndërkombëtare u hoq detyrimi i rregullimit të tarifës nga AKEP.
- Bazuar në vendimet për FNT të operatorëve celularë më datë 4.07.2012, operatorët celularë **nuk janë më me FNT për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare** dhe nuk asnjë detyrim për këto thirrje sipas neneve 39-45 të ligjit 9918, pra nuk kanë detyrim për të dhënë akses, mos-diskriminim, orientim në kosto, rregullim tarife etj.

13. Pra asnjë prej sipërmarrësve celularë, përfshirë dhe Vodafone Albania, për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet e tyre që prej datës 1.09.2012 nuk kanë pasur dhe nuk kanë status me FNT dhe as detyrimet e përcaktuara për FNT në nenet 39-45 të ligjit 9918, si dhënie akses, mos-diskriminim, orientim në kosto, rregullim tarife etj. Terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, trajtohet në marrëveshje të vecanta tregtare mes operatorit ofrues të terminimit të thirrjeve dhe atij tranzitues, gjithmonë nëse është në interesin komercial edhe të operatorit terminues të thirrjeve.

14. Pas de-rregullimit të tarifës së terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare AKEP ka trajtuar disa raste të ngjashme, për të cilat janë marrë vendime dhe mund të gjendet të publikuara në faqen ëeb të AKEP:

- VKD Nr.1957, datë 24.05.2012 Për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1882, datë 19.04.2012, Per “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Vodafone Albania sh.a.””

Ky vendim citohet edhe nga vetë Neofone në ankimin e depozituar, dhe AKEP në pikën III të arsyetimit të vendimit ka argumentuar sa më poshtë:

Për sa i përket periudhës nga data e pranimit të kërkesës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe fillimit të procedimit administrativ sipas VKD nr. 1882, datë 19.04.2012 “Për Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Vodafone Albania sh.a”, bazuar në faktet dhe pretendimet e parashtruara nga palët duke iu referuar bazës ligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi në atë periudhë, mosmarrëveshja duhet të çmohet duke marrë në konsideratë se AKEP me VKD nr.1740 datë 20.12.2011, ka vendosur që tarifa e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituarra të jetë jashtë rregullimit duke filluar nga data 1.02.2012. Njëkohësisht AKEP me VKD nr.1886, datë 19.04.2012 ka miratuar edhe shtesat dhe ndryshimet përkatëse të RIO së AMC, ku janë materializuar vendimet e AKEP-it për këtë çështje. Në këto kushte palët për nivelin e tarifës (çmimin) për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara duhet të bien dakort midis tyre mbi bazën e negociatave në kushtet e lirisë kontraktuale për vendosjen e një çmimi në përputhje me interesat reciproke komerciale. Sipas këtij kushti sipërmarrësi Vodafone Albania ka lidhur marrëveshtjet e interkoneksionit dhe me sipërmarrësit e tjerë të interesuar. Duke iu referuar fakteve të paraqitura nuk rezulton që Vodafone Albania të mos ia ketë ofruar Neofon-it të njejtën tarifë që ka lidhur edhe me sipërmarrësit e tjerë për këtë shërbim. Ka qenë Neofone ajo që nuk e ka pranuar këtë tarifë të Vodafonit, duke mos marrë në konsideratë faktin që tashmë kjo tarifë është jashtë rregullimit nga AKEP-i.

VKD Nr.2069, datë 21.06.2012 Për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1974, datë 1.6.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.””

Në këtë vendim, në lidhje me mos-marrëveshjen për tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin Nisatel, AKEP ka arsyetuar ndër të tjera sa më poshtë vijon:

Për sa i përket tarifës së terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin Nisatel, thirrje të tranzituara nga Albtelecom, vëmë në dukje se:

....

Nëse Nisatel nuk është dakort me tarifën/tarifat e propozuara nga Albtelecom, Nisatel ka mundësinë që të mos pranojë këtë shërbim nga Albtelecom dhe të marrë thirrje hyrëse ndërkombëtare nga operatorë të tjerë tranzitues ose nëpërmjet vet-

tranzitimit. Albtelecom nuk është operatori i vetëm tranzitues i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në Shqipëri, madje ka një numër të konsiderueshëm operatorësh që kanë kryer këtë shërbim (përfshirë Nisatel) për terminim drejt operatorëve celularë dhe Albtelecom;

15. Për sa më sipër, de-rregullimi i tarifave të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare nga 1.02.2012 dhe heqja e statusit me FNT dhe gjithë detyrimeve të mëparshme për këto thirrje nga data 1.09.2012, nënkupton se këto tarifa dhe marrdhëniet midis operatorëve për këtë shërbim nuk janë nën-rregullim nga AKEP dhe tarifatat përcaktohen lirisht në marrdhënie kontraktuale midis palëve të interesuara, të autorizuar për të ofruar shërbime të tilla të komunikimeve elektronike. Kjo periudhë de-rregullimi i plotë përfshin edhe periudhën 9.10.2015 e deri aktualisht (objekt i mos-marveshjes) dhe Vodafone Albania nuk ka status me FNT për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare dhe asnjë prej detyrimeve të përcaktuara në nenet 39-45 të ligjit 9918 për këto thirrje, dhe AKEP nuk mund të detyrojë Vodafone Albania të lidhë marrëveshje aksesit/interkonkesioni me një operator tranzitues për terminimin e këtyre thirrjeve dhe as të rregullojë/përcaktojë tarifën e këtij shërbimi, përfshirë në procedura zgjidhje mos-marveshjeje.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të procedurës së përcaktuar Ligjin nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 114, neni 115 si dhe Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 44/2015) neni 130 e në vijim,

V E N D O S:

1. Të mos pranojë ankimin e sipërmarrësit Neofone sh.p.k dërguar me shkresë nr. prot 287 datë 02.12.2015 (referenca e AKEP: nr. 2148 prot., datë 03.12.2015) për zgjidhjen e mosmarveshjes midis Neofone sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a.
2. Ngarkohet DTMR të njoftojë sipërmarrësin Neofone sh.p.k për këtë vendim.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afatit 45 ditor të përcaktuar në Ligjin 49/2012.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

Kryetar

Ilir ZELA

Anëtar

Ketrin TOPÇIU

Anëtar

Edlira DVORANI

Anëtar

Xhoana LILAJ